



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

NJOFTIM PER MEDIA

Referuar interesimit të medias, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, informon sa më poshtë:

Policia gjyqësore, ka referuar se më datë 21.02.2024, rreth orës 20:30 gjatë patrullimit nga shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja” në lagjen Nr.15, Durrës në afërsi të universitetit është vënë re i ndaluar një automjet tip “ Mercedes- Benz” me targa AB.... Nga ana e shërbimit është bërë verifikimi i kësaj targe nga salla operative dhe ka rezultuar se kjo targë i përkiste një automjeti tip “Land Rover” e cila ishte denoncuar e vjedhur, drejtuesi i këtij automjeti është i dyshuar shtetasi me iniciale **A.S**, ku është bërë i mundur arrestimi i tij.

Mbi kërkesën e Prokurorisë Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka zhvilluar gjykimin lidhur me vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, Deklarimin e Moskompetencës të Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për hetimin e procedimit penal të vitit 2024, ndaj personit nën hetim shtetasi me iniciale **A. S**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “*Vjedhjes*” dhe “*Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik*”, të parashikuar nga nenet 134/2 dhe 242 të Kodi Penal

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 125, datë 24.02.2024, ka vendosur:

1. Të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasis **A. S**, i dyshuar përkryerjen e veprës penale “*Vjedhja*” të parashikuar nga neni 134/1 dhe “*Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik*”, parashikuar nga neni 242 i K. Penal.
2. Të caktojë ndaj shtetasis **A. S** masën e sigurimit personal “*arrest me burg*” me afat 2 muaj duke filluar nga data e sotme, më 24.02.2024 parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për zbatim.
4. Të shpallë moskompetencën e Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për hetimin e procedimit penal të vitit 2024.

5. Dërgimin e akteve të hetimeve paraprake të këtij procedimi për kompetencë hetimi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
6. Dërgimin e kësaj dosjeje gjyqësore Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Seksioni Penal.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, personi nën hetim me iniciale A. S, i cili kërkoi shfuqizimin e vendimit.

Në përfundim të gjykimit, më datë 19.03.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga trupi gjykues me Gjyqtar z. Dritan Hasani, vendosi:

Miratimin e vendimit Nr. 125, datë 24.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në lidhje me vleftësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë.

-Mospranimin e ankimi të personit nën hetim **A. S.** lidhur me caktimin e masës së sigurimit.

Në vijim, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si gjykatë kompetente, ka zhvilluar gjykimin lidhur me vlerësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal, ndaj personit nën hetim shtetasit me iniciale **A. S.**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “*Vjedhjes*” dhe “*Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik*”, të parashikuar nga nenet 134/2 dhe 242 të Kodi Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 612 Akti, datë 08.03.2024, ka vendosur:

-Miratimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë për personin nën hetim A. S.

-Caktimin si masë sigurimi për personin nën hetim atë të “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr. Penale.

-Urdhërohet lirimi i personit nën hetim nëse ndaj tij nuk ka ndonjë masë tjetër sigurimi ose vendimi të formës së prerë.

Çështja në apel u shqyrtua mbi bazën e ankimit të bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Prokurori pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. Genti Xholi, gjatë gjykimit, në seancë gjyqësore, hoqi dorë nga ankimi i ushtruar.

Në përfundim të gjykimit, më datë 03.04.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga trupi gjykues me Gjyqtar z. Dritan Hasani, vendosi:

- Mospranimin e ankimit të paraqitur nga prokurori kundër vendimit Nr.612 Akti, datë 08.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM